



BASHKIMI EVROPIAN HAP NEGOCIATAT ME SHQIPËRINË PËR GRUP-KAPITUJT "THEMELORET"

Konferenca e dytë Ndërqeveritare u mbajt në Luksemburg, ku mori pjesë delegacioni shqiptar i kryesuar nga Kryeministri Edi Rama, e në përbërje të të cilit ishte Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani. Për qeverinë shqiptare ky është një moment historik, kurorëzimi i përpjekjeve të mëdha të deritanishme në fushën e mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit.



RAPORTI I KE: SHQIPËRIA NË RRUGËN E DUHUR DREJT ANËTARËSIMIT NË BE

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mirëpriti komunikimin e Komisionit Evropian mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së dhe raportin 2024 për Shqipërinë, i cili thekson përparimin e Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani theksoi se njohja e progresit të Shqipërisë, pasqyron angazhimin e fortë në përparimin e reformave dhe për të fituar ritmin në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.



DEBATI NË KËSHILLIN E SIGURIMIT, HASANI: MË SHUMË MBËSHTETJE PËR GRATË NË ZONAT E KONFLIKTIT

Nju Jork, 24 tetor 2024

Në Debatin e Hapur të Këshillit të Sigurimit për agjendën "Gratë, Paqja dhe Siguria", ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, vuri theksin në hendekun ekzistues mes angazhimeve globale dhe zbatimit aktual të kësaj agjende, veçanërisht në situatën shqetësuese për gratë në zonat e konfliktit.



HASANI: SHQIPËRIA, E PËRKUSHTUAR PËR TË VIJUAR KONTRIBUTIN E SAJ NË LUFTËN KUNDËR ISIS-IT

Në Takimin e Ministrave të Jashtëm të Koalicionit Global Kundër ISIS, në Washington D.C., më 30 shtator 2024, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani vuri në pah rolin e vendit tonë dhe kontributin ndaj Koalicionit, si dhe konfirmoi se Shqipëria do të vijojë të jetë partnere e përkushtuar në mbështetjen e misionit të tij të luftës kundër ISIS.



MINISTRI HASANI: QEVERIA SHQIPTARE E PËRKUSHTUAR NDAJ ZHVILLIMEVE NË LUGINËN E PRESHEVËS

Tiranë, 19 tetor 2024

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, në takimin e zhvilluar me kryetaren e Komunës së Luginës së Preshevës, Ardita Sinani, rikonfirmoi mbështetjen dhe angazhimin e veçantë të Qeverisë Shqiptare ndaj zhvillimeve në Luginën e Preshevës dhe problematikave me të cilat përballen shqiptarët atje.



SAMITI I VI GRUAS SHQIPTARE TË DIASPORËS, HASANI: VOTA E DIASPORËS, NJË MOMENT HISTORIK PËR DEMOKRACINË SHQIPTARE

Tiranë, 11 tetor 2024

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, në fjalën e tij gjatë Samitit të V të Gruas Shqiptare të Diasporës, vuri theksin te rëndësia e pjesëmarrjes së grave të diasporës në procesin zgjedhor të ardhshëm, duke e cilësuar votën e tyre si një moment historik për demokracinë shqiptare.



NISMA E MEPJ, HASANI: PROMOVIM PROFESIONISTËVE TË DIASPORËS

Tiranë, 8 tetor 2024

"Angazhimi me profesionistë të Diasporës", nisi me një event të dedikuar aktivitetit profesional dhe artistik të gazetarit, profesorit dhe shkrimtarit frankofon, Skënder Sherifi, në mjediset e MEPJ. Në ceremoninë në nder të 50-vjetorit të veprimtarisë krijuese të shkrimtarit, ministri Hasani theksoi se, përmes kësaj nisme, MEPJ synon të vlerësojë kontributet e bashkëkombësve tanë jashtë vendit, duke forcuar lidhjen e thellë mes Shqipërisë dhe komunitetit të saj global.